



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 46

Prishtinë, më 17.1.2012, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Nijazi Idrizi, Salih Morina, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Etem Arifi, Rasim Demiri.

Mungoi : Daut Haradinaj, Liburn Aliu.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: zyrtar nga MB, bashkëpunëtor, përfaqësues dhe vëzhgues të interesuar (KDI, OSBE), media.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës ,**
- 2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 16.1.2012,**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit për Prizrenin,**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 16.1.2012

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 16.1.2012.

3. Shqyrtimi i projektligjit për Prizrenin

Kryetari Nait Hasani përshëndeti të pranishmit dhe sugjeroi komisionin të shqyrtohet kapitulli i fundit, ngase kapitulli III do të shqyrtohet nesër me ministrin e MMPH bashkërisht, i cili mungon në mbledhjen e sotme.

Në vazhdim komisioni filloi me shqyrtimin e nenit 23 me vërejtjet si vijon :

Amendamenti 12

Neni 23, pas nënparagrafit 1.1 shtohet një nënparagraf, tjerat rinumërohen, si vijon :

1.2 informimit të publikut mbi rëndësinë dhe statusin e mbrojtur të qendrës historike të Prizrenit.

Në nënparagrafin ekzistues 1.2 në fund “shquar shumetnike” zëvendësohet me fjalën “**pasur**”.

Paragrafi 2, në fund fshihet fjalia “**dhe Zyra e Qendrës Historike të Prizrenit, në mënyrë që ajo të miratohet**”.

Amendamenti 13

Neni 24, paragrafi 2, në mbledhjen e radhës, zyrtarët e MMPH të riformulojnë shtesën “**Komuna aplikon për lehtësira fiskale....**”.

Amendamenti 14

Neni 25, fshihet paragrafi 2, ndërsa në paragrafin 3 hiqet “**nga Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës**”.

Amendamenti i përbashkët i Komisionit, Qeverisë dhe deputetit Hydajet Hyseni.

Mbledhja e komisionit përfundoi në orën 14,50.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani